

Aslihan Xhaferi

V A R G J E S H P R E S E



Tetovë
2020

Aslihan Xhaferi

V A R G J E S H P R E S E

*Nëntor
2020*

“Mënyra më e mirë për të korruptuar një të ri është ta udhëzosh të ketë mendim më të lartë për ata që mendojnë si ai, se sa ata që mendojnë ndryshe”.

U jam mirënjohës të gjithë ata që më ndihmuan në realizimin e kësaj vepre, e vçanërisht falemenderoj familjen time, të cilët gjatë tërë kohës më kanë përkrahur moralisht e materialisht.

*Me respekt
Aslihan Xhaferi*

Atdheun tim

Atdheun tim

Sa shumë e dua,

Sa i bukur, sa i shtrenjtë

Do ngelesh për mua.

Kudo që jam

Kudo që shkoj,

Atdheun tim

Kurrë se harroj.

Me male e fusha

Me shumë gjelbërim,

Askund nuk gjej

Si atdheun tim.

Babit

*Babin tim unë e dua
Sepse m'i plotëson dëshirat mua,
Çdo herë punon
E kurë nuk më hidhëron.*

*Çdo dëshirë më polotëson
Dhe mua më lumturon
Shkoj në shtëpi
Me dëftesën me pesa në dorë,
Babit tim ia tregoj
Dhe shumë e lumturoj.*

Dashuria

*Portreti i jashtëm
Mos të ta mashron syrin,
Mos thuaj me vete
E gjeta më të mirin.*

*I bukur, i paster,
Që s'ka zemër fare,
Por zemra nuk blëhet
Gjithnjë me pare.*

*Ai që ka zemër
E që ka pastërti,
Ka vlerë njerzore
E gjithmonë është njeri.*

Ditëlindje

*Një ditë, të shtatorit
Ditëlindjen festova,
Amrën, Elizën, Ernisen,
Nafisen dhe Belkisën
Në fetstë i ftova.
Me dhuratat e tyre,
Të bukura në duar,
Ditëlindjen ma uruan,
E shumë më gëzuan.
Unë i falemenderova
Për dhuratat që m'i dhuruan.*

Jeta

*Çfar të duhen sytë
Kur libra s'lexon,
Çfar të duhet mendja
Kur mësimet si kujton,
Çfar të duhet qoha
Kur detyrat si bën,
Ehh, çfar të duhet kjo jetë
Kur atë se shijon.*

Jetimi

*Jeta juaj duhet të që të vlerë,
Që të mos zhduket për një herë,
Të fortë të qëndroni,
Dhe botën të ndryshoni.*

*Vuajtjet tuaja larg dëgjohen,
Nga këto vuajtje edhe malet dridhen,
E gjithë toka bëhen copë copë,
E ca njerëzit nuk mërziten dotë.*

*Bëje jetimin të buzëqesh,
Buzëqeshja atij i mungon,
Nga syri kur më të mos rrjedh
As edhe një pikë lot.*

*T'iu ndihmojmë në drejtësi,
T'iu ndihmojmë në bamirësi,
Jëtë të ua zbuqurojmë,
Vështërsitë ti tejkalojnë.*

Karantina

*Hyre në mes nesh,
Si lojë fëmijërore,
Oh moj karantinë,
Në këtë jetë ç'na bëre.*

*Në karantinë qëndruam,
U vetë izoluar,
Nga familjarë u ndam,
E shkollën se pamë.*

Katër stinët

*E para është pranvera,
Që shumë na gëzon;
Me ngjyrat e bukura,
Lulet i zbuquron.*

*E dyta, është vera.
Atëherë çel manaferra.*

*Pastaj vjen vjeshta
Kopshiti me pemë rreshta.
Era fryn dhe fishkëllon,
Mbi tokë gjethet i rrëzon*

*Stina e fundit dimri
Fëmijët i gazmon,
Me ngjyrë të bardhë
Natyren e pikturon.*

Lazdrani i vogël

*Emiri i vogël lazdrak,
Më ra në kockë me bardak,*

*E mora lapsin që emrin tim ta shkruaj,
Lina e Besa më ngatruan.*

*Mora gomën me shpejtësi,
Por shkrimi nuk u fshi.*

*Me Linën e Besën u hidhërova,
Sepse më ngatruan, dhe fletoren
Nga hidhërimi më shkatruan.*

Lulja

*Bejza shoqja ime,
Ndalu mos u ngut,
Lules merri erë
Por mos e këput.*

*Lulja që këpute,
Petlat iu thanë,
Po këpute lulen,
Gjithë natyra qanë.*

Lizës

*Liza mori Liza
Fustanin me tulla
Që ma dhuroi Nëna
Për ditëlindjen mua
Ma kishite coptuar.*

*U mërzita fillova të qajë
Nëna kur më pa
Fustanin tjetër
Menjëherë ma bleu.*

*Fshiva lotët
E përqafova nënën e lumtur
Me gëzime e falemenderova
Për fustanin që ma kishite blerë.*

Nënë

*Nënë, ti më linde
Ti më rrite e edukove,
Shumë gjëra tjera
Me zell mi mësove.*

*Nënë, ti ke aromë
Që mua më lumturon,
Përqafimi yt i ngrohtë
Mua më qetëson.*

*Nëna ime je ti
Gjysma e zemrës sime
Je si ylber me shumë ngjyra,
Sa herë del jashtë
Buzëqesh natyra.*

*Në krahërorin tënd
Shumë dashuri fitova,
Me përgdheljen tënde
U rrita dhe u gëzova.*

*Nënë,
Emër me katër shkronja të arta,
Që lulëzojnë kudo
Ti je drita e shtëpisë
Dhe simbol i dashurisë.*

Një ditë

*Një ditë je e gëzuar,
Një ditë je e vetmuar,
Një ditë dikush të mashtron,
E kur në jetë nuk i beson.
Një ditë dikush të hidhëron,
Dhe kur në jetë nuk i beson,
Të gjithë këto i kalova
E kur nuk u dorëzova.*

Një miqe

*Një miqe e vërtetë
Çdo herë të ndihmon,
Një miqe e vërtetë
Çdo herë të mirën të do,
Një miqe e vërtetë
Çdo herë të respekton,
Një miqe e vërtetë
Çdo herë për për ty lufton,
Një miqe e vërtetë
Nuk të dallon veç në ditë të mira
A të vështira...*

Njerëzit

*Njeriu lufton
Asnjëherë në jetë
Nuk dështon.*

*Një njeri me dy fyrtjyra
Mund të jetë si dielli
Me shumë ngjyra.*

Shoqes sime

*Kam një shoqe
Shumë të bukur,
Ajo gjithmonë
Më bën të lumtur.*

*Por një ditë
Më erdhi një lajm i trishtuar,
Ajo kur më tregoi
Se në mërgim kishite shkuar.*

*U mërzita u pikëllova,
Por i thash se nga zemra
Kur s'do e largoja.*

Të trishtuar

*Ishte ditë e martë
Ditë me plot trishtime,
Mësuesit na thanë
Sdo ketë më mësimë.*

*Shumë virusi i keq
Gjithëve po na mbyt,
Fëmije e pleq
Të habitur rrinë.*

*Do të vi dhe fundi
Të gjithë do e tejkalojmë,
Ne fëmijët të gëzuar
Mësimin do ia fillojmë.*

Vëllau

*Kush ka vëlla botën ka,
Vëllau të ndihmon,
Në çdo gabim që ti bën.*

*Vëlla emër me katër shkronja
Që gjithë botën ndriçon,
Fjalën vëlla e themi
Fjalë që në zemër e këmi.*

*Vëllau motrës çdo herë
Të mirën ia dëshiron,
Kur në jetë nuk lejon
Dikush motrën ta dëmton.*

Vera

*Verë moj e bukura verë,
Me ndriçimin tënd,
Sjell shkëlqimin çdo herë.*

*Fëmijët me vrap
Shkojnë në shitore,
E me kënaqësi
Blejnë akullore.*

*Pishina fëmijët i fton
E me ujin e tij
Trupin t'ua freskon.*

Vendlinja

*Në vendlindjen time
E lumtur dua të jetoj,
Në mërgim as në ëndër
Nuk kam menduar të shkoj.*

*Dua të flas gjuhën time
Të trashiguar ndër breza,
Ashtu siç e flet familja ime
Në vendlindjen time.*

Vit i ri

*Mirë se erdhe
Në mesin tonë,
Moj festë e bukur,
Me plotë aromë.*

*Mezi të prisja të vish
Që shokët e shoqet
Të mi gëzosh.
Me stoli e fishekzjare
Ty moj festë të festojmë,
Fëmijët e lagjes sime i gëzon.*

Vjeshta

*Erdhi vjeshta
Në fsahitin tim,
Gjethet bien era fryen.*

*O moj vjeshtë
Stinën tuaj
Në çdo vizatim
E kam pikturuar,
Sepse çdo sekret
Neve na ka mbuluar.*

*Të deshta të dua
Siç ishim më parë,
Në vjeshtën tjetër
Do jemi të pandarë.*

Zogu

*Kam një zog
Shumë të bukur,
Ai më bën
Shumë të lumtur.*

*Ciu, ciu, ciu
Natë e ditë bën,
E neve fëmijëve
Shumë na gëzon.*

22 Nëntorit

*Ditë plotë gëzim
Për ju fëmijë,
Ditë plotë shkëlqim.*

*Nxtoni me dëshirë
Për në shkollë të mësoni,
Me shkronjat që janë krijuar
Me 22 Nëntor.*

*Bëjni një resht,
Krijoni vargje me shpejtësi
Sepse shkronjat shqipe,
Në nëntor janë bekuar.*

*Ruani alfabetin
Sy sytë e ballit
Sepse alfabeti
Shkëlqen si dritë e arit.*

Enisi i vogël

*Enisi i vogël lazrak,
Më ra ne qokë,
Me një bardak,
Qokën ma dëmtoi
Por edhe më hidhroi.*

*U habit kur më pa ashtu,
Me shpejtesi nënës i tregoi
Në spital më derguan,
E qokën ma shëruan.*

Gara

*Breshka e lepuri
Në garë kishin dalë,
Kush në finish
Do të del më i parë.*

*Fillon Lepuri të lavdrohet,
Edhe pak të lazdohet,
Thotë i pari unë do jem,
Dhe trofeun do ta kem.*

*Breshka fare nuk fliste,
Mendjen në garë e kishte,
Me dredhi lepurin e mashtroi,
Edhe garën e fitoi.*

28 Nëntorit

*Me 28 nëntor,
Ngritën flamurin tonë,
Skënderbeu më i pari
E pastaj Ismail Qemali.*

*Sa të gëzuar në këtë ditë jemi,
Flamurin kuq e zi në duar kemi.*

*Këtë ditë e feston mbarë shqiptaria
Se në këtë muaj erdhi pavarësia,
Muja i shënjtë është nëntori
Për të dhanë jetën shumë dëshmor.*

Mësuesit

*Një mësues zemër bardhë,
Mua më ndihmoi,
Në rrugë të drejtë të jetës,
Ai më orientoi.*

*Vite vite kanë kaluar,
Unë s'ri dot pa e kujtuar,
Mësuesin tim të parë,
Që vargje më mësoi,
Unë me zell të krijtoj.*

*Një dhuratë të bukur më falë,
Më qëndoi gjithmonë pranë,
Njohuri e dituri më ofroi,
Në rrugë të drejtë më udhëzoi.*

Dimri

*Iku vjeshta erdhi dimri
Erdhi bora, erdhi gëzimi,
Dordolecin e ndërtojmë
E rreth tij vallëzojmë.*

*Dimër, o dimër i bukur
Me plotë bardhësi
Fëmijët rëshqasin
Në obor me sajë e ski.*

Ora

*Akrepat e orës
Ecin dalë nga dalë,
E ndjekin njëri tjetrin
Sikur të jenë në garë.*

*Ai më i gjati
Me tur e vrap vrapon,
Rrrotullohet rreth e qarkë,
Që agrepi i vogël të hedh një hap.*

*Ora tik tak bën
Neve na kujton
Me vëmendje ta shiqojmë,
E kohën e saktë
Nga ajo të kuptojmë.*

*Ora në mëngjes
Fëmijët i zgjon
Të bëhen gati
Në shkollë të shkojnë.*

Gabojmë, apo jo

*Nuk ka njeri në këtë botë,
Fare që nuk gabon,
Gabim quhet edhe nese pa vetëdije ,
Ndonjëherë, ndonjë lëndojmë.*

*Nëse bëjëm gabim
Duhet përmirësuar,
Gabim e bërë
Duhet kuptuar.*

*Kur gënjejmë dikë
Edhe veten lëndojmë,
Çdo herë që gënjejmë
Edhe të tjerët i lëndojmë.*

Ëndrrat e mia

*Eh, sikur një shkop magjik-
të zanave ta kisha
Ëndrrat e mia ti realizoja
Të shikoja gjithandej
Botën ta shikoja.*

*Kam shumë ëndëra
Shpresoj t'i realizoj
Të punoj, të studijoj
Edhe unë nxënësit e mi
Një ditë t'i mësojë.*

*Eh sa shumë dëshira kam unë
Ëndrroj e shumë netë ri pa gjumë
T'i mendoj të tëra me rradhë
Si të ishin në një përrallë.*

Vargje shprese

*Vargje shprese kam krijuar
Janë rradhitur një nga një,
Jam munduar që të krijtoj
Jetës sonë t'ia dedikoj.*

*Vargje shprese, vargje besimi
Që të na bëjnë
Të lumtur këtë jetë,
Të mos shuhen si vesë blerimi
Po të jetë fjalë e vërtetë .*

Tradhëtia

*Fjala dashuri
Shpesh të lëndon,
Zemrën ta then
Shpirtin ta shkatron.*

*Dshuria është e shenjtë
Për njerëzit që kanë mend,
Dashuria i mallkton
Të gjithë ata që tradhëtojnë.*

Klasës sime

*Sa shpejt kaluan ditet
Sa shpejt kaluan vitet
Sa shpejt erdhëm në fund.*

*Erdhi koha të ndahemi
Momentet e bukura ti kujtojmë
Momentet e mërzitura ti harojmë.*

*Për ne do të nis një jetë ndryshe
Të tjerë shokë e shoqe do ta kjojmë
Shoqërinë e vjetër nuk duhet ta harojmë.*

*Arsimtarët janë munduar
Për të na mësuar e edukuar,
Atyre falje duhet t'u kërkojmë
Për momentet që kemi gabuar.*

Gjyshes sime

*Gjyshen time
Shumë e dua,
Asnjëherë nuk
Më hidhëron mua.*

*Çdo dëshirë
Më plotëson,
Çdo gjë mua
Më dhuron.*

*Gjyshen time
E kam si nënë te dytë
Edhe unë i ndihmoj
Për çdo gjë që ka nevojë.*

Babadimri

*Babadimër o mjekër bardhë
Për çdo vjet në fshat kë me ardhë,
Nxënësave dhuratave për t'iu sjellë
E vitin e vjetër për ta përcjellë.*

*Qofshë me jetë Baba Gjysh
Nuk na harove kurrë
Të presim me padurim,
Që edhe vititeve të ardhëshme
Dhuratat të na sjellësh me gëzim.*

Shkollës time

*Ca vargje ca strofë
Ia kushtoj shkollës sime,
Në të mësova shumë mësimë.*

*Në shkollën time
Shumë kohë kaloj,
Andaj në jetën time
Kurë s' do ta haroj.*

*Është vendi që na falë dshuri,
Është vendi që na falë lumturi,
Është vendi që na falë dituri.*

*Arsimtarët dritë na falin
Na këshillojnë e na mësojnë
Që të bëhemi të urtë të mirë
Që gjithë jetën të jemi të lirë.*

*Amanetin në vend do ua çojmë
Fjalët juaja do i respektojmë
Të kujdesemi për të gjithë
Nga fëmijëria e deri në pleqëri.*

Lulebora

*Luleborë moj luleborë
Që çel në pranverë,
Kopshtin tim të vogël
E mbush me aromë.*

*Stinë e bukur me lule plot
Fush e male me gjelbërim,
Pranverë në natyrë
Pranverë në zemrën tonë.*

Përmbajtja

<i>Atdheun tim</i>	4
<i>Babit</i>	5
<i>Dashuria</i>	6
<i>Ditëlindje</i>	7
<i>Jeta</i>	8
<i>Jetimi</i>	9
<i>Karantina</i>	10
<i>Katër stinët</i>	11
<i>Lazdrani i vogël</i>	12
<i>Lulja</i>	13
<i>Lizës</i>	14
<i>Nënë</i>	15
<i>Një ditë</i>	17
<i>Një miqe</i>	18
<i>Njerëzit</i>	19
<i>Shoqes sime</i>	20
<i>Të trishtuar</i>	21
<i>Vëllau</i>	22
<i>Vera</i>	23
<i>Vendlinja</i>	24

<i>Vit i ri</i>	25
<i>Vjeshita</i>	26
<i>Zogu</i>	27
<i>22 Nëntorit</i>	28
<i>Enisi i vogël</i>	29
<i>Gara</i>	30
<i>28 Nëntorit</i>	31
<i>Mësuesit</i>	32
<i>Dimri</i>	33
<i>Ora</i>	34
<i>Gabojmë, apo jo</i>	35
<i>Ëndrrat e mia</i>	36
<i>Vargje shprese</i>	37
<i>Tradhëtia</i>	38
<i>Klasës sime</i>	39
<i>Gjyshes sime</i>	40
<i>Babadimri</i>	41
<i>Shkollës time</i>	42
<i>Lulebora</i>	43

Jeta nuk mund të të jep dhuratë më të çmuar, se sa bukurinë e përkryer të një miqësie të Artë!

Nuk besoj se ka diç më të vlefshme në këtë botë, që mund ta zbukuroj shpirtin, sesa kur e kupton se ekziston pranë teje një mik/esh i/e cili/a të ushqen për çdo ditë me nektarin më të ëmbël të jetës...

Miqësia e singertë është brilanti më i shkëlqyeshëm i botës!

(<https://www.sa-kra.ch/thenieartamiqesi.htm>)



Aslihan Xhaferi

Është nxënëse në Shfk “Fan Noli” f. Pallaticë.
Poezitë të para të saja i kë postuara në rrjetet sociale personale dhe te faqja e shkollës. Ka marr pjesë në shumë aktivitete shkollore ku ka shpalos talentin e saj krijues.
“Vargje shprese” është vepra e parë e sajë.
Bashkjeton me familjen në f. Pallaticë